



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:104221
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05728829

CP.nr.1794/2021

GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Tahiri,, në lëndën përbarimore të kreditorit A. M. te cilin e përfaqëson me autorizim avokat Lutfi Tahiri me seli ne Prishtine, ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës – Drejtoria e Arsimit - Mitrovicë, lidhur me pagesën e borxhit ne baze te dokumentit përbarimor - Aktgjykimi C.nr.866/2020, te datës 05.08.2021, të lejuar me aktvendimin për përbarim CP 1794/21, te datës 22.04.2022, jashtë seance gjyqësore, me datën 23.05.2024 morri ketë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përbarimore e udhëhequr sipas shenjës CP 1794/21, me kreditor,. ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës – Drejtoria e Arsimit - Mitrovicë, për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitori.

A r s y e t i m

Kreditorja e përbarimit A. M, te cilin e përfaqëson me autorizim avokat Lutfi Tahiri me seli ne Mitrovicë, ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës – Drejtoria e Arsimit - Mitrovicë, ka paraqitur propozim për përbarim në bazë të dokumentit përbarimor - Aktgjykimi 866/2020, te datës 05.08.2021.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të përbarimit, me aktvendimin CP 1794/21, te datës 22.04.2022, ka lejuar përbarimin ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës – Drejtoria e Arsimit – Mitrovicë.

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP 1794/21, te datës 22.04.2022, është bere i ekzekutueshëm, kreditori me datën 03.05.2024, ka njoftuar gjykatën se debitori i përbarimit e ka përmbushur në tërësi borxhin.

Andaj, borxhi i kërkuar sipas propozimit për përbarim është përmbushur në tërësi, pasi që debitori ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit të përbarimit, gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të LPP-së, në të cilin parashihet se *“Pas përmbushjes se kredisë*

se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbartimore”, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
CP.nr.1794/2021 më datë 23.05.2024

Gjyqtari
Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditorë nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Mitrovicë.